



Nr. 101/1 Prot.

Tiranë, më 08. 07. 2024

z. Fatmir Xhafaj
Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar
Kuvendi i Shqipërisë
Tiranë, Shqipëri



Lënda: Përcjellje e materialeve në fushën e shtetit të së drejtës

I nderuar z. Xhafa,

Gjej rastin të shpreh konsideratat më të larta për punën e Kuvendit të Shqipërisë si institucioni përgjegjës për hartimin, diskutimin dhe miratimin e ligjeve dhe akteve të tjera me rëndësi thelbësore në lidhje me funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri. Kështu, krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Posaçëm Parlamentar, besoj se do të prodhojë produkte me vlerë në lidhje me thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030.

Në përgjigje të ftesës suaj për bashkëpunim, të cilën e pranoj me kënaqësi, po ju përcjellim një sërë materialesh të hartuara nga Qendra Europiane ka hartuar dhe prezantuar për grupe të ndryshme përfituesish në lidhje me fushën e sundimit të ligjit. Ndër këto materiale janë:

1. Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut 2019-2023 – miratuar me vendim të Kuvendit nr. 47/2019;
2. Raport monitorimi për funksionimin e ligjit për konsultimin publik dhe të drejtën për informim 2024;
3. Raport monitorimi për konstituimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor – 2021;
4. Plani i Integritetit për punonjësit e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë;
5. Konflikti i interesit dhe etika mes gjyqtarëve dhe prokurorëve: standardet evropiane në nivel vendor;
6. mi i buxhetimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë 2021-2025;
7. Roli i medias në rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE: manual;
8. Analizë ligjore: procesi i riintegritetit të të miturve në konflikt me ligjin dhe koordinimi ndër institucional;



9. Protokoll pune: Bashkëpunimi ndër institucional në kuadër të rehabilitimit dhe riintegrimin të të miturve në konflikt me ligjin;
10. E drejta e pronës në vështrim të standardeve europiane: manual;
11. Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes në lanten e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Gjithashtu, më lejoni të theksoj se është bërë një punë permanente dhe voluminoze sa i takon edukimit ligjor të publikut dhe ofrimit të shërbimeve ligjore falas për shtresat vulnerabël, të cilët kanë mungesë të njohurive juridike dhe pafuqi financiare.

Aktualisht, Qendra po vazhdon punën së bashku me UNDP Shqipëri në lidhje me edukimin e grupeve vulnerabël për mundësitë e shërbimeve ligjore falas, si dhe përdorimin e shërbimeve publike online.

Për çdo informacion apo sqarim të mëtejshëm, mbetemi në dispozicionin tuaj.

Me respekt,

Ina XHEPA

Qendra Europiane